



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235367
Datë: 15.12.2023
Numri i dokumentit: 05074518

C-IV-14-0846

Ankuesi

B G, Prizren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 12 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ017-0162 datë 05 mars 2013.
2. **OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankueses **B G** (në emër të bashkëshortit të saj Ruzhdi Gashi – tani i ndjerë) në emër të kërkesës për dëmshpërblimin lidhur me ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, t’i paguaj **shumën prej 1,740.00 €**.
3. Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 14 shkurt 2014, gjykata lëshoi një urdhër të brendshëm për Zyrën e Regjistrimit që lëndën me nr. C-II-13-0031 ta regjistroj me numër të ri për Kolegjin e Specializuar të Likuidimit pasi lënda të bie në kompetencë të tij. Lënda u regjistrua nën numrin C-IV-14-0846.

Me 25 mars 2013, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRZ017-0162 i datës 05 mars 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin vendim ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e saj për dëmshpërblim për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës (së bashkëshortit të saj) në shumë prej 1,740.00 €, nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” Prizren. Ankuesja pohon se bashkëshorti i saj ka qenë punëtor i NSH “Ramiz Sadiku” deri më 21 shkurt 2006 dhe se ndërmarrja më pas ishte nën administrimin e AKM tani AKP e cila ndërmarrje sipas

detyrës zyrtare kishte kompletuar listën e të punësuarve me të drejtë pjesëmarrjeje në pjesën që u takon pas përfundimit të procedurës së privatizimit. Ankuesja më tej pohon se bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë me 01 shkurt 2009 dhe sa ishte gjallë e ka marrë shumën e të hollave që i ka takuar sipas valës së parë të privatizimit, ndërsa për pjesën tjetër që do i takonte tani më të ndjerit jam paraqitur si trashëgimtare e tij. Ankuesja më tej pohoi se vendimi i ankimuar është i pabazuar edhe nga fakti se pas vdekjes së bashkëshortit që ka qenë punëtor në NSH-në e cekur më lartë, sa ka qenë gjallë ai nuk ka pas nevojë ta autorizoj personin tjetër për realizimin e të drejtës së tij me rastin e privatizimit të ndërmarrjes ku kishte punuar dhe se këtë të drejtë automatikisht e ka fituar bashkëshortja e të ndjerit. Ankuesja konsideron se vendimi i AKP është i padrejtë dhe se shuma që i ka takuar bashkëshortit të saj tani i takon bashkëshortes së tij këtu parashtueses së ankesës dhe se duke pasur parasysh provat në shkresat e lëndës vendimi i AKP përveç që është i padrejtë po ashtu parashtuesja e ndien edhe veten të diskriminuar lidhur me rastin. Ankuesja i propozon gjykatës që ta aprovoj ankesën si të bazuar. Në mbështetje të ankesës së saj ankuesja dorëzoi dëshmitë në kopje si: Certifikatën e martesës nr. 234 datë 13 janar 2010, Certifikatën e vdekjes nr. 120 datë 05 mars 2010, Certifikatën e saj të lindjes nr. 152 datë 11 shkurt 2010, Certifikatën e lindjes (së bashkëshortit – tani të ndjerë) nr. 279 datë 04 mars 2010 dhe Librezën e tij të punës.

Me 08 janar 2014 gjykata lëshoi urdhër përmes së cilit ndër të tjera kërkoi vendimin e atakuar, të cilin ankuesja e dorëzoi brenda afatit të paraparë në urdhër.

Me 30 dhjetor 2019, ankuesja nëpërmjet Zyrës Rajonale (ZR) për Ndhimë Juridike Falas – Prizren, dorëzoi në gjykatë një kërkesë për lirim nga taksa pasi ajo është shfrytëzues i ndihmës juridike falas. Në mbështetje të saj dorëzoi Vendimin për aprovimin e kërkesës së saj për lejimin e ndihmës juridike falas lëshuar nga Agjencia Për Ndhimë Juridike Falas ZR Prizren nr. C.nr.402/19-02 datë 28 dhjetor 2019 dhe Vërtetimin nr. 04/4599, datë 27 dhjetor 2019, lëshuar nga Departamenti i Pensioneve me të cilin vërtetohet se ka realizuar të drejtën në pension bazë.

Me 30 qershor 2020, e paditura parashtroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Neni 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet ankuesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. E paditura më tej pohon se bazuar në çështjen e certifikatës së vdekjes, R G ka vdekur më datë 02 nëntor 2009 dhe kërkesa është nënshkruar dhe dorëzuar nga bashkëshortja e tij B G pa patur një akt përfaqësimi për të përfaqësuar të ndjerin. Neni 359 i Ligjit “*Mbi obligimet*”, parashikon se: “*Në rast vdekjeje të debitorit ose kreditorit, obligimi do të përfundojë nëse ka lindur si rezultat i karakteristikave personale të palëve kontraktore ose të statusit personal të debitorit*”. Kërkesa për dëmshpërblim

për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës lidhet me një obligim të krijuar si pasojë e statusit personal të R G si punëtor i NSH-së dhe rrjedhimisht nuk mund ti kalojë palëve të treta. AL ka dalë në përfundim se çdo detyrim i mundshëm i NSH-së ndaj R G ka përfunduar në momentin e vdekjes së tij dhe për më tepër bashkëshortja e tij B G nuk disponon një akt përfaqësimi të vlefshëm për të përfaqësuar R G Bazuar në sa më sipër dhe në përputhje me Nenin 7.6.4 të Politikave Operacionale të AKP-së, ky AL konstaton që ankuesit nuk i takon e drejta për përfitim nga dëmshpërblimi për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës dhe rrjedhimisht kërkesa refuzohet. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 36.2 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes ka bashkangjitur në kopje Vendimin për Emërimin e Anëtarëve të AL, datë 30 shtator 2019.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesja (në emër të bashkëshortit të saj tani të ndjerë) ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRZ017-0162 i datës 05 mars 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,740.00 € nga NSH "NIN Ramiz Sadiku" (në *likuidim*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë

e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH “NIN Ramiz Sadiku”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Ankuesja pretendon se bashkëshorti i saj (tani i ndjerë) ka qenë punëtor i NSH-së, deri sa ndërmarrja ka shkuar në privatizim me datë 21 shkurt 2006. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se R G ka vdekur më datë 02 nëntor 2009 dhe kërkesa është nënshkruar dhe dorëzuar nga bashkëshortja e tij B G pa patur një akt përfaqësimi për të përfaqësuar të ndjerin si dhe në kuptim të nenit 359 të Ligjit “*Mbi obligimet*”, i cili parashikon: “*Në rast vdekjeje të debitorit ose kreditorit, obligimi do të përfundojë nëse ka lindur si rezultat i karakteristikave personale të palëve kontraktore ose të statusit personal të debitorit*”, kërkesa për dëmshpërbllim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës lidhet me një obligim të krijuar si pasojë e statusit personal të R G si punëtor i NSH-së dhe rrjedhimisht nuk mund ti kalojë palëve të treta. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e tij të punës dhe as lartësinë e pagesës së kërkuar.

Ankuesja, bazën e kërkesës e mbështet në librezën e tij të punës si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH “NIN Ramiz Sadiku” 01 tetor 1983 deri më 21 shkurt 2006 (momenti edhe kur është privatizuar NSH-ja).

Gjykata i pranon si prova relevante librezën e tij të punës si dhe pohimet e ankueses të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se i njëjti ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 1,740.00 €, në emër të dëmshpërbllimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 76.7.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën të cilën e ka llogaritur vetë ankuesja në kërkesën e saj në procedurë të likuidimit tek AL si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës së tij në gjykatë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se ankuesit nuk i takon kompensimi në këtë rast pasi kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës lidhet me një obligim të krijuar si pasojë e statusit personal të R G si punëtor i NSH-së dhe rrjedhimisht nuk mund ti kalojë palëve të treta, është i pabazuar. Gjykata vlerëson se fakti që R G (ish bashkëshorti i ankuses – tani i ndjerë) ka vdekur, nuk do të thotë që me vdekjen e tij ka pushuar edhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e kërkuar nga ankuesja. I njëjti ka qenë i gjallë në kohën e privatizimit të NSH-së dhe ky fakt është vërtetuar nga të dhënat e ofruara nga dëshmitë përkatëse civile të dorëzuara me ankesë. Prandaj, neni 359 i LMD, nuk është i zbatueshëm në këtë rast, sepse dispozita në fjalë i referohet rasteve të detyrimeve që kanë lindur si rezultat i karakteristikave personale të palëve kontraktuese dhe si të tilla shuhen me rastin e vdekjes së njëres nga palët, e që ky nuk është rasti pasiqë në rastin konkret kemi të bëjmë me të drejtën për kompensim në emër të kërkesës për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, që dihet nga parimi se të drejtat dhe sendet që iu përkasin individëve mund të trashëgohen. Prandaj, gjykata vlerëson se ankuesja ka të drejtë në kompensimin në emër të kërkesës për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës dhe kërkesa e saj aprovohet.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se R G ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që ankuesja është duke marr ndihmë ligjore nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar

.